



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 60/09

Prishtinë, më 16.09.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Armend Zemaj, Riza Smaka, Müfera Şinik, dhe Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), dhe Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Bedri Hamza zv. ministër i MEF-it, Lulzim Ismajli - drejtor i Dep. të Thesarit në MEF, Lars Lage Olofsson-Auditor Gjeneral, Qerkin Morina zv. Auditor nga ZAP. Ismet Krasniq - Sekretar i Kuvendit të Kosovës, pjesëmarrës nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2606/DO-016 dt. 14.08.2009, gjashtëmujor të buxhetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2009**
I ftuar : Ahmet Shala , Ministër i MEF - it;
- 3. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2645/ Ra-018 dt. 10.09.2009 vjetor të Auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008**
I ftuar : Lars Lage Olofsson , Auditor i Përgjithshëm;
- 4. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2547/Do-1595 dt. 17.07.2009 të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtë mujorin e parë të viti 2009**
I ftuar : Ismet Krasniqi , Sekretar i Kuvendit të Kosovës;
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, propozoi që rendi i ditë të plotësohet edhe me dy pika. Njëra ka të bëjë me kërkesën buxhetore të Kuvendit për vitin e 2010, në bazë të qarkores së dytë buxhetore të MEF-it 2010/02, që do të jetë pika e 5, ndërsa pika tjetër është shqyrtimi raportit për projektligjin për masat antidamping me raportin e komisionit funksional, me amendamente, që do të jetë pika e 6 e rendit të ditës.

Rendit ditës miratohet me plotësimin e dy pikave të lartpërmendura.

2. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2606/DO-016 dt. 14.08.2009, gjashtëmuor të buxhetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2009

Bedri Hamza, theksoi se raporti është hartuar konform dispozitave ligjore dhe i njëjti i është dërguar Kuvendit brenda afatit ligjor. Nga të hyrat e përgjithshme të planifikuara prej 965 milion €, gjatë periudhës gjashtëmuore janë realizuar 420 milion € e planit vjetor (duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondet me mirëbesim), apo shprehur në përqindje 43%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje prej 2.9%, në veçanti në investimet kapitale. Kjo ka ndodhur si rezultat i ngritjes së efikasitetit të institucioneve që inkasojnë të hyra (Administratës Tatimore dhe Administratës Doganore). Sa i përket strukturës së të hyrave, në kufij janë realizuar 64.5% e totalit të përgjithshëm, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje prej 3.3%. Të hyrat e brendshme 23.1%, rritje prej 1.8% krahasuar me periudhën paraprake. Të hyrat komunale 5%, 17% më tepër se vitin e kaluar. Të hyrat vetanake të nivelit qendror 4%, krahasuar me vitin e kaluar kemi rritje prej 8.7%. Të hyrat tatimore joqeveritare 6% (ku bëjnë pjesë edhe gjobat që iu kthehen si të hyra vetanake komunave). Sa i përket shpenzimeve nga 1,176 miliard € sa janë planifikuar, janë realizuar 397,131 milion € apo në përqindje 33.7% e totalit të përgjithshëm, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje prej 21.6%. Sa i përket strukturës së shpenzimeve, për “paga dhe mëditje” 36%, që kemi rritje prej 17% nga periudha e kaluar (shpenzimet për arsim, krijimi i institucioneve të reja). Për “mallra dhe shërbime” realizimi është prej 14%, rritje prej 10% krahasuar me periudhën paraprake (barnat esenciale, krijimi i institucioneve të reja). “Shpenzimet komunale” 2%, 5% me të larta se vitin e kaluar. “Subvencione dhe Transfere” 32%, krahasuar me periudhën paraprake kemi rritje prej 25%. “Shpenzimet kapitale” 20%, për dallim nga periudha paraprake kemi rritje prej 35%.

Myrvete Pantina, theksoi se shifet se gjatë kësaj periudhe ka trende pozitive në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Krahasuar me planin buxhetor jemi të kënaqur me të hyrat, por jo edhe me shpenzimet. Vlerësoj shumë rritjen e të hyrave nga ATK-ja. Sa i përket shpenzimeve në nivelin komunal efikasitetit i tyre është më i madhë se sa në nivelin qendror. Shifet se kemi rënie të të hyrave nga akciza për duhanin, banderolat, shitjen e mallrave apo pasurisë, rënie nga gjobat dhe dënimet, të hyra nga inspektimet 100% më të ulta, për të gjitha këto kërkoi sqarime. Sa i përket shpenzimeve kapitale realizimi i tyre është shumë i ultë në krahasim me planin (17%). Ndërsa subvencionet dhe transferet janë realizuar më mirë. Në këtë drejtim kërkoi sqarim për “subvencionet për entitetet jopublike”.

Haki Shatri, theksoi se realizimi i të hyrave gjatë kësaj periudhe është nën planin (42%), megjithëse periudha e dytë e vitit është koha e realizimit të të hyrave, dhe pres që të ndodhë kjo. Sa i përket shpenzimeve kapitale në nivelin qendror, shifet një dinamikë e ngadalshme e realizimit të tyre (17%), kur dihet se shumë projekte janë vazhdimësi e vitit të kaluar. Theksoi se është brengosëse se si ka mundur që në këtë raport të futen projekte që nuk janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin e vitit 2009. Rasti i Ministrisë së Shëndetësisë (9 projekte të reja), Ministrisë së Transportit, te pjesa e bashkëfinancimit, janë paraqitur 11 milion € në raport, nga 4 milion € sa kanë qenë të lejuara në

buxhet. Përveç kësaj në nivelin qendror shifet se kemi edhe shpenzime tjera të larta, si shpenzimet e telefonit (€ 1,5milion), për karburant (€3milion), avance të pambyllura (€750.960), dreka zyrtare (501.000€). Si dhe shpenzimet për karburant për TMK-në (€10.000).

Besa Gaxherri, theksoi se nga raporti shifet se ka ngritje të të hyrave krahasuar me vitin e kaluar, por ngecje në raport me buxhetin e planifikuar. Rritja është një gjë e natyrshme, pasi që jemi në proces të zhvillimit ekonomik të vendit. Vlerësoi ngritje e kapaciteteve të ATK-së edhe pse mbetet për tu bërë më shumë. Konsideroi të papranueshme realizimin e shpenzimeve prej 34%, e prej tyre vetëm 10% shpenzime kapitale. Këto shpenzime në kontinuitet po realizohen dy muajt e fundit të vitit. Shpenzimet tjera si avancet e pambyllura (mbi €750.000), drekat dhe darkat zyrtare (€500.000), karburantet për institucionet qendrore (€3milion), për telefon (€1,5milion), të gjitha këto janë të shumta. Kërkoi sqarim për shpenzimet e larta për karburant për TMK-së. Konsideroi të papranueshme realizimin e projekteve që nuk janë planifikuar në buxhet.

Armend Zemaj, theksoi se raporti përmbush kushtet ligjore dhe nga ai shohim rezultate pozitive në realizimin e të hyrave, duke përfshirë edhe nivelin komunal. Ndërsa sa i përket shpenzimeve duhet përshpejtohet dinamika e tyre, kur dihet se tani edhe është plotësuar ligji i prokurimit, me të cilin lejohet një dinamizëm më i madh i punëve. Pasi që jemi në fazën e planifikimit të buxheti, MEF-i duhet bërë analiza të realizimit të buxhetit nga organizatat buxhetore, në mënyrë që të metat mos të përsëriten. Sa i përket shpenzimeve për drekat zyrtare, ndarja e tyre duhet bërë sipas nevojave dhe aktiviteteve. Është e pakuptueshme se si disa komuna të vogla kanë shpenzuar dreka zyrtare më tepër se disa ministri.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin e përgatitur mirë i cili përfshinë të gjitha shënime të kërkuara me ligj. Kemi shënime të detalizuara, sidomos për mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale. Në lidhje me realizimin e buxhetit, theksoi se edhe herave tjera në mbledhjet e Komisionit e ka shprehur shqetësimin, se nuk kemi arritur të kemi një planifikim të mirë buxhetor, dhe kjo po reflekton në realizimin buxhetit. Mirëpo kohëve të fundit po bëhet ngritja e kapaciteteve, dhe si rezultat po kemi një planifikim dhe realizim më të mirë të buxhetit. Në këtë drejtim nuk mund të anashkalohet ndryshimi i politikave tatimore, e që përkundër kësaj ATK-ja ka arritur të realizojë të hyra më të mëdha dhe kjo të reflektohet pozitivisht në buxhetin e Kosovës. Edhe të hyrat komunale kanë shënuar rritje dy vitet e fundit. Sa i përket shpenzimeve kapitale është e dëshirueshme që ato të jenë 50%, por natyra e tyre nuk lejon që në këtë periudhë të realizohen. Por është për tu vlerësuar rritja e tyre prej 35% në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu është për tu vlerësuar performanca e mirë e shpenzimeve për mallrat dhe shërbime, megjithë faktin i krijimit të institucioneve të reja.

Riza Smaka, vlerësoi raportin korrekt dhe profesional. Nga raporte dalin disa indikator për disa tema që duhet të ishin pak me ndryshe. Shpenzimet e tepërta për dreka zyrtare, avancet e pambyllura, për telefon janë të larta dhe në kundërshtim me ligjin. Po ashtu shkelje ligjore paraqesin edhe realizimi i projekteve të paplanifikuara. Shumë institucione publike veprojnë në objektet private, që janë pa leje urbanistike dhe qiratë që paguhen janë në nivele të ndryshe, duhet tejkaluar kjo situatë.

Kryesuesi, pyeti se qfarë është pagesa për sindikatë dhe si bëhet ajo?

Bedri Hamza, sa i përket pyetjes së realizimit të buxhetit, historikisht në pjesën e dytë të vitit kemi realizim më të madhë të të hyrave dhe shpenzimeve. Kjo situatë ndodh edhe me shpenzimet kapitale. Sa i përket akcizës në cigare, duke pasur parasysh faktin se kemi pasur ngritje të akcizës nga 17-21€ biznesit në fund të vitit 2008 kanë importuar më shumë cigare, dhe kjo ka ndikuar që në këtë periudhë të kemi më pak import. Me këtë çështje janë të lidhura edhe banderolat. Për gjobat supozohet se kemi disiplinë më të madhe. Ndërsa për shpenzimeve për telefon dhe derivate, nëse merren parasysh krijimi i institucioneve të reja, krahasuar me periudhën e kaluar janë më të pakëta,

por ka ndikuar edhe ulja e tarifave telefonike. Shpenzimet e karburantit për TMK-së i kemi prezantuar ato që kanë ndodhur. Ndërsa në pyetjen për projektet e reja në raport, theksoi se Ligji mbi buxhetin parashe lëvizjen e projekteve prej një organizate në tjetrën, por ai nuk përcakton se ku shkojnë ato projekte. Në këtë drejtim MEF-i nuk do të kishte lejuar të veprohet në kundërshtim me ligjin. Për dreka dhe darka zyrtare disa ministri kanë harxhuar më shumë për shkak të aktiviteteve që kanë, por nuk e kanë tejkualuar buxhetin e lejuar. Ndërsa për pagesën e qirasë në objekte private, është në proces të vendosjes së institucioneve në objekte publike.

Lulzim Ismajli, në pyetje për pagesën për sindikatë, theksoi se si rezultat i një marrëveshje në mes Ministrisë së Administratës Publike, MEF-it dhe Sindikatave, punëtorët paguajnë nga paga neto e tyre përmes organizatave buxhetore për sindikatë. Arsyeja e pasqyrimin në raport si kategori e veçantë, është bërë për shkak të transparencës.

Haki Shatri, theksoi se projekti në vlerë prej 2 milion € i cili nuk ka kaluar për miratim në Kuvend, nuk do të duhej paraqitur në raport, dhe kjo është në kundërshtim me ligjin.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që në seancën plenare, të miratojë Raportin gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

3. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2645/ Ra-018 dt. 10.09.2009 vjetor të Auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008

Lars Lage Olofsson, theksoi se është raporti i ZAP-së prezanton shpenzimet e buxhetit dhe raportin e ZAP-së si organ llogaritëdhënës. Kemi prezantuar çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mirë, qeverisjen e mirë, për administratën publike profesionale dhe kontrollin e brendshëm. Kemi dhënë konkluzione për raportin e auditimit të brendshëm dhe të prokurimit, ku kemi cekur të gjeturat. I kemi pranuar planet e veprimin nga organizatat buxhetore për të tejkualuar problemet, për çka edhe kemi marrë ftesa individuale nga shpenzuesit buxhetor për të ndihmuar në këtë drejtim. Kemi dhënë rekomandimet tona se qfarë hapa duhet të ndërmerret Kuvendi, dhe kemi sugjeruar që të diskutohet për raportet që kanë marrë opinion jo të kualifikuar. Jemi në proces të riorganizimit të zyrës sonë për të filluar me auditime të reja, në këtë proces kemi nevojë për resurse të reja dhe për mbështetje financiare për të kryer më shumë auditime.

Armend Zemaj, vlerësoi raportin cilësor dhe përmbajtësor. Puna që është bërë më jep motiv shtesë të mbështes auditorin e jashtëm për të vepruara sipas ligjit. Në raport është cekur dallimi në mes mungesës menaxheriale dhe shkeljes ligjore. A është mungesa menaxheriale shkelje ligjore. Si dhe çështja e dytë përcjellja e rekomandimeve nga vit në vit, për të parë ndryshimet pozitive dhe negative. Në këtë drejtim, a mbetet që Kuvendi të bëjë presion mbi organizatat buxhetore, apo ju të kërkoni nga këto organizata për përmisimin e performancës dhe zbatimin e ligjeve si dhe eliminimin e dukurive të cekura.

Haki Shatri, theksoi se nga raporti i Qeverisë për buxhetin kam nxjerrur të dhëna se nuk është respektuar ligji për buxhetin. Janë futur projekte kapitale të cilat nuk janë miratuar në buxhetin e vitit 2008. Raporti i auditimit nuk e përmend këtë element, pyeti a nuk është ligji i buxhetit në sferën e juaj të auditimit? Po ashtu për një numër të mëdha të projekteve, kontrata është lidhur me ofertuesit më të shtrenjtë të përgjegjshëm. Diferenca në mes ofertuesit më të lirë dhe të shtrenjtë arrin vlerën € 20 milion. Në raport nuk është cekur projekti i përfshirë në Ministrinë e Administratës Publike, të

cilin e ka refuzuar Kuvendi, a nuk ka qenë kjo qështje objekt interesimi për auditorin?. Është e pakuptueshme se si institucionet janë lavdëruar për punë të shkëlqyeshme, kur nga ky raport ka një numër të gjeturash, si: mungesa e kontratave për të punësuarit, problemet me prokurimin, mungesa kontrolleve të brendshme, kontrollet ekzistuese janë anashkaluar, etj.

Kryesuesi, duke i përgjigjur parafolësit, për projektin e përfshirë në Ministrinë e Administratës Publike, theksoi se në fillim Kuvendi nuk e ka miratuar këtë projekt, ndërsa në rishikim të buxhetit është aprovuar dhe është prezantuar në linjë të veçantë buxhetore.

Besa Gaxherri, vlerësoi raportin cilësor dhe në aspektin teknik gjithëpërfshirës. Në këtë drejtim theksoi jemi të interesuar të mbështesim këtë zyrë, që të jetë e pavarur dhe profesionale. Pyeti pse janë larguar auditorët nga Ministria e Transportit? Përndryshe Komisioni duhet t'iu përkrah që të jeni të pavarur dhe të papenguar në punën e juaj.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se kjo zyrë gëzon pavarësinë kushtetuese, dhe nga ky raport po shifet se ajo po ruhet. Përpjekjet e komisionit për ta përkrahur këtë zyrë, po shihet se po japin rezultate pozitive. Përgëzoje zyrën e auditorit për punën e bërë, dhe theksoi se do të përcjell në kontinuitet implementimin rekomandimeve për të gjetura për organizatat buxhetore, si për shkeljet e mëdha po ashtu edhe për ato të vogla. Në raport është cekur se kontrollet e brendshëm kanë munguar, gjë që edhe ne e kemi konstatuar me rastin e monitorimit të ligjit të auditimit të brendshëm. Një problem tjetër i evidentuar janë mungesa e evidencave kontabël. Pyeti a kanë filluar organizatat buxhetore të aplikojnë këtë sistem të evidencave kontabël, dhe si është gjendja reale?

Kosara Nikolić, vlerësoi raportin mirë të përgatitur dhe theksoi se e mbështet punën e kësaj zyre. Në raport është cekur se fondi i privatizimit nuk është në buxhetin e Kosovës, i cili po të ishte do të ndikonte në zbutjen e krizës ekonomike. Në këtë drejtim qfarë mund të ndërmerrni ju si zyrë?

Myrvete Pantina, theksoi se konstatimi i auditorit se pasqyrat financiare janë në përputhje me ligjin dhe paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtet, është shumë i rëndësishëm. Mirëpo nga të gjeturat, si: mosharmonizimi me ligjin e prokurimit, mangësi në kontrollin e brendshëm, shpalosja joadekuate e aseteve fikse, dështimi në bazën ligjore skemës pensionale, etj., shifet se ka ende punë për të bërë, për menaxhimin me efikas të mjeteve buxhetore. Të jepet afati kohorë për plotësimin e rekomandimeve. Pyeti pse nuk është audituar fondi i privatizimit?

Riza Smaka, vlerësoi raportin mirë të hartuar, nga i cili material rezultojnë disa defekte që shqetësojnë këdo. Ndër të gjetura tjera thuhet: se ka defekte në regjistrat e kontabilitetit, prezantim të mangëta të vlerave të aseteve, lëshime të ndryshëm të prokurimet, punësim pa kontratë, auditimi intern nuk funksionon, akceptim të ofertave më pak të volitshme, rasti lëshimeve në menaxhimin e procedurave të menaxhimit të RTK-së, që të gjitha këto paraqesin shkelje flagrante të procedurave ligjore. Shifet se aktet ligjore subordinohen ndaj akteve nënligjore. Prandaj duhet propozuar amendimin e ligjit, që auditori të ketë të drejtë të kërkojë nga prokuroria dhe organet e ndjekjes ndërmarrjen e masave ndaj përgjegjësve dhe shkelësve të ligjit, e jo vetëm dhënien e rekomandimeve.

Hajdin Abazi, vlerësoi raportin të përgatitur profesionalisht. Janë prezantuar në mënyrë precize llojet e të metave dhe kualifikimi i tyre. Do të ishte mirë që të shtohet një pjesë për të krahasuar gjendjen si ka qenë më parë dhe si është tani, me qëllim që të shikohet si kanë shkuar rrjedhat. Pajtohemi me rekomandimet e auditorit që të ndërmarrim masa ndaj organizatave buxhetore për të përmisuar gjendjen. Te rasti i RTK-së, ligji aktual nuk i lejon auditorit, të audiojë pasqyrat e plota financiare të RTK-së. Me rastin e ndryshimit të ligjit të RTK-së, duhet të heqen këto kufizime, në mënyrë që auditori të ketë autorizime të plota në auditimin e pasqyrave financiare.

Kryesuesi, theksoi se pajtohet me pjesën më të madhe të rekomandimeve dhe do të përcjell implementimin e tyre nga organizatat buxhetore. Megjithatë ka vend për vërejte, raporti është thirrur në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe nuk është thënë se Kosovës i mungon ligji për kontabilitetin dhe raportimet financiare. Si rezultat i kësaj zbrazëtire juridike, organizatat buxhetore në raportet e tyre po thirren në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe nuk po përshtatin pasqyrat e tyre financiare me ligjet e brendshme. Rasti i tillë është raporti i RTK-së për vitin 2008, pas shqyrtimit të së cilit kemi konstatuar se raporte nuk përmbush kushtet ligjore dhe standartet e raportimit financiar. Në bazë të rekomandimit tonë, Kuvendi me vendim ka kërkuar të plotësohet ky raport, dhe deri më tani nuk kemi pranuar një raport të plotësuar. Ndërsa kjo zyrë në auditimin e saj ka theksuar se raporti financiar i RTK-së për vitin 2008, që është dorëzuar në Kuvend paraqet në mënyrë të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të RTK-së. Bazuar në këtë, kam marrur një letër nga kryetarja e bordit të RTK-së, që thirret në raportin e juaj, se i njëjti përmbush standartet e kontabilitetit financiar, dhe kërkon sugjerime nga Komisioni për mënyrën e hartimit të raportit. Prandaj duhet të rishikohet çështja e konstatimeve të auditorit për këtë raport.

Lars Lage Olofsson, duke u përgjigjur në pyetjet, theksoi se arsyeja që nuk ka bërë krahasime me vitet e kaluar qëndron në faktin se këto raporte nuk janë të ngjashme me ato të kaluarat. Në rekomandimet tona kemi cekur se ligjet dhe rregulloret nuk janë gjithëmonë konsistente në procesin e menaxhimit dhe kontrollit financiar. Po ashtu janë cekur personat që janë përgjegjës dhe që duhet dhënë llogari për keqmenaxhimi e tyre. Kemi cekur pagesat që janë bërë pas 20 dhjetorit. Sa i përket ndërrimit të auditorëve nga Ministria e Transportit kjo çështje është iniciuar nga udhëheqësi i ekipit. Ndërsa është e vërtetë që nuk kemi audituar fondin e privatizimit. Raporti i RTK-në, është ndër auditimet më të mirë që kemi bërë këtë vit, mirëpo për të sqaruar situatën, kemi menduar të organizojmë një dëgjim të veçantë me përfaqësuesit e RTK-së. Theksojmë se kjo zyrë vepron në mënyrë të pavarur, përveç pavarësisë financiare, që është e varur nga MEF-i.

Kryesuesi, theksoi se raporti tre faqesh i RTK-së nuk mund të konsiderohet se i plotëson standartet e raportimit financiar. Konstatimet e juaja janë në kundërshtim me rekomandimet e Komisionit dhe të Kuvendit. Prandaj Komisioni nuk do të aprovojë këtë raport dhe është në pritje të plotësimit të raportit financiar të RTK-së.

Lars Lage Olofsson, në auditimin e raportit të RTK-së jemi bazuar në legjislacionin ekzistues dhe kemi konstatuar se ai i përmbush kërkesat ligjore, reflekton se çka ka ndodhur, por informatat e ofruara nuk janë të mjaftueshme.

Kosara Nikolić, propozoi që rekomandimi i Komisionit të jetë se përkrahet raportin e Zyrës së Auditorit, pa pjesën e raportit për RTK-në. Për të sqaruar këtë çështje do të duhej të organizohej një dëgjim i posaçëm, ku do të marrin pjesë Komisioni, përfaqësuesit e RTK-së dhe të ZAP-së.

Hajdin Abazi, pasi kemi të bëjmë me dy konstatime të ndryshme në mes Kuvendit dhe Zyrës së Auditorit për raportin e RTK-së, duhet shikuar më kujdes kjo çështje.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në seancën plenare, të miratojë Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, me përjashtim të raportit të auditimit për raportin financiar të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2008.

4. Raportit nr. 03/2547/Do-1595 dt. 17.07.2009 të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtë mujorin e parë të viti 2009

Ismet Krasniqi, kërkoi që Komisioni ti rekomandojë Kryesisë, ndërsa Kryesia Kuvendit, për të marrë një vendim të qartë për projektin “qendra administrative protokolare –Gërmija”, sepse figurimi i tij në buxhet, po ndikon që investimet kapitale të mos realizohen.

Kryesuesi, theksoi se nëse nuk ka vërejtje, propozoi që rekomandimi i Komisioni të jetë që përveç përkrahjes së raportit, të rekomandojmë që Kuvendi të dal me një vendim të qartë për projektin “Qendra administrative protokolare – Gërmija”. Njëkohësisht një tjetër rekomandim duhet të jetë që të implementohet buxheti i Kuvendit në kategorinë paga dhe mëditje, konform buxhetit të vitit 2009.

Besa Gaxherri, theksoi se është në interes të Kuvendit që të vazhdohet projekti kapital “Qendra administrative protokolare –Gërmija”.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës, që në seancën plenare, të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2009.
- II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës, të marrë vendim të prerë për projektin kapital “Qendra administrative protokollare - Gërmija”, ose në të kundërtën i njëjti të hiqet nga kërkesa buxhetore e Kuvendit për vitin 2010.
- III. Të implementohet buxheti i Kuvendit të Kosovës, në linjën paga dhe mëditje, sipas rekomandimeve të Komisionit dhe brenda kufijve buxhetor të përfshira dhe miratuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, respektivisht në Ligjin nr. 03/L-167 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, në bazë të qarkores së dytë të MEF-it 2010/02

Ismet Krasniqi, theksoi se propozim buxheti i Kuvendit për vitin 2010 është €8.900 milion, ndërsa projeksionet për vitin 2011, €9,600 milion. Kërkoi që ky Komision, të dal me një rekomandim që programi “Fondi për demokratizim” të hiqet nga buxheti i Kuvendit, dhe të kalojë në një organizatë tjetër buxhetore, pasi që edhe nuk raportohet për shpenzimi e tyre. Nëse ky hiqet, si dhe vendoset diçka për projektin “protokollar Gërmija”, buxheti i Kuvendit do të jetë vetëm €6 milion.

Haki Shatri, propozoi që programi “fondi për demokratizim” të kalojë në MEF, pasi që kanë staf më të përgatitur për administrimin e tij. Gjithashtu propozoi që komisioni të dal me një propozim që buxheti i Kuvendit të aprovohet si agjencioni pavarur dhe jo të kalojë përmes procedurave të MEF-it.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në bazë të qarkores së dytë të MEF-it 2010/02, të miratojë kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

- II. Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, t'i rekomandojë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, që në procesin e planifikimit buxhetor për vitin 2010, të bartë programin "Fondi për Demokratizim për Partitë Politike", nga buxheti i Kuvendit të Kosovës dhe të vendos në kuadër të buxhetit të organizatës buxhetore – Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si program i veçantë buxhetor.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping me raportin me amendamente të komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoj nga anëtarët të deklarohen për Projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional lidhur me mundësinë e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme

Armend Zemaj, theksoi se jemi ankuar se nuk kemi zyre si deputetë, ndërsa Administrata e Kuvendit ka planifikuar pranimin e punëtorëve të ri, pyeti sekretarin se ku do të vendosen këta punëtorë?

Ismet Krasniqi, në përgjigjen e parafolësit, theksoi se jemi në pritje të lirim të aneksit të ri nga Ministria e Transportit dhe e Drejtësisë, dhe kështu do të krijoheshin më shumë zyre si për stafin, ashtu edhe për deputetë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI